



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 304/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.304/2019, e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.304/2019, të datës 06.10.2019, dhe plotësimin e ankesës Anr.304/2019, të datës 07.10.2019, të paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar, se subjekti politik LVV, ka thyer heshtjen zgjedhore, ngase ka sponsorizuar fotografi në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP dhe Rregullat Zgjedhore, me propozim për PZAP-in, që ankesa të pranohet si e bazuar dhe subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjislacionit zgjedhor. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa njoftime të printuara, të nxjerra nga web faqja Lëvizja për Drejtësi, në cilësi të provave materiale.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive me njoftime të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtresuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka bërë sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësit të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësit të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kanë qenë jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.304/2019 më datën 07.10.2019

**Kryesues i Panelit**

Fejzullah Rexhepi



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*